



# USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 36 (827683)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 11 Shtator 2020

## Forca Tokësore



### Pas stërvitjes 12 javore, përfundon Kursi XVI "Komando"

Ditën e hënë më 7 shtator 2020, në mjediset e batalionit Komando, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit XVI "Komando". Në këtë ceremoni morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel David Rroku, komandanti i batalionit Komando

nënkolonel Edmond Doda, komandantë të reparteve të Forcës Tokësore si dhe familjarë të kursantëve. Ky aktivitet, ndryshe nga herët e tjera, nisi me demonstrime stërvitore, ku të ftuarit në këtë ceremoni patën rastin të shihnin nga afër veprimet e trupave "Komando" në disa stacione si: kalimi i brezit... >>> faqe 5

## Akademia e Forcave të Armatosura

### Xhaçka: Fillon raundi i dytë i aplikimeve, zgjidhje e sigurtë punësimi



>>> faqe 3

## Komandanti i KFOR-it vizitë zyrtare në vendin tonë KFOR-i kontribues për sigurinë dhe ruajtjen e paqes në rajonin e Ballkanit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor, Bajram Begaj priti në takim Komandantin e KFOR, gjeneralmajor Michelle Risi. Motoja e Ris është "Stabilitet të Qëndrueshëm" >>> faqe 2



## BFS dhe bML

### Drejtuesit e rinj: Nënkolonel Ajet Jata dhe kolonel Petrit Dajlani

Ditën e martë, më 8 shtator 2020, në mjediset e Batalionit të Forcave Speciale (bFS) dhe Batalionit të Mbështetjes me Luftim (bML) u zhvillua ceremonia e prezantimit të komandantëve të batalioneve. Në këtë ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, shefi i Shtabit të FT kolonel Ilirjan Dauti...



>>> faqe 4

## "Dhuro Gjak-Shpëto Jetë"

### Forcat e Armatosura i bashkohen nismës së dhurimit të gjakut

Nën kujdesin Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Bajram Begaj, efektivë të Forcave të Armatosura më datë 4 shtator 2020, kanë dhuruar vullnetarisht gjak në ambientet e Garnizonit "Skendërbej", duke iu përgjigjur pozitivisht iniciativës "Dhuro Gjak-Shpëto Jetë", për të kontribuar në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe njerëzve në... >>> faqe 7

### STËRVITJA "URA E GJELBËR-2020"

## Forcat Ajrore të Bullgarisë dhe Greqisë kryejnë fluturime të përbashkëta

>>> faqe 13

### AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

## Gati për nisjen e kursit 1-vjeçar për oficer, përfundon testimi fizik

>>> faqe 3

### 1920-2020: 100 VJETORI I LUFTËS SË VLORËS

## Debat në strukturat italiane për Luftën e Vlorës të vitit 1920

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ >>> faqe 6



**N**ë kuadër të bashkëpunimit të FARSH me Komandën e KFOR, zhvilloi ditën e enjte, më 3 shtator 2020, një vizitë zyrtare në vendin tonë, Komandanti i KFOR, gjeneralmajor Michelle Risi, i cili u prit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor, Bajram Begaj.

Në takimin e zhvilluar midis shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Begaj dhe komandantit të KFOR gjeneralmajor Risi, u vlerësua roli i KFOR-it në sigurinë dhe ruajtjen e paqes në rajonin e Ballkanit.

Gjatë fjalës së tij në takim, SHSHPFA, pasi shprehu mirënjohjen e burrave dhe grave nën uniform, të cilët shërbejnë në KFOR, ku edhe Shqipëria është pjesë, vlerësoi me nota pozitive rolin e gjeneralmajor Michelle Risi, në drejtimin e KFOR që prej nëntor 2019.

Nga ana e tij, gjeneralmajor Risi pasi e përgëzoi gjeneralmajor Begaj për marrjen e detyrës së lartë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, vlerësoi performancën e personelit ushtarak që shërbejnë në KFOR, të cilët me rritjen profesionale dhe eksperiencën e përfituar do të jenë një vlerë e shtuar për FARSH në të ardhmen.

Të dy bashkëbiseduesit gjatë takimit ndanë të njëjtat qasje për situatën e sigurisë në rajon, rolin e NATO si dhe vijimin e bashkëpunimit mes FARSH dhe KFOR edhe në të ardhmen. “NATO është e bindur në mënyrë të vendosur për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor përmes forcës paqeruajtëse të KFOR-it me 3.500 trupa në Kosovë”, deklaroi Jens Stoltenberg Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, në takimin në Bruksel me kryeministrin e Kosovës Avdulla Hoti më 7 shtator 2020. Ai nënvizoi se: “mandati i KFOR-it mbetet i pandryshuar: të mbajë një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur dhe lirinë e lëvizjes për të gjithë njerëzit në Kosovë, në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 të vitit 1999”.

\*\*\*

Gjeneral-major Michele Risi e mori detyrën si Komandanti i ri i KFOR-it, më 20 nëntor 2019. Detyrën e komandës e mori nga Komandanti Lorenzo D’Addario, në prani të Komandantit të Forcave të Përbashkëta Aleate në Napoli, Admiralit James G. Foggo III, presidentit të Kosovës Z.Hasim



KOMANDANTI I KFOR-IT VIZITË ZYRTARE NË VENDIN TONË

# KFOR-i kontribues për sigurinë dhe ruajtjen e paqes në rajonin e Ballkanit

*Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor, Bajram Begaj priti në takim Komandantin e KFOR, gjeneralmajor Michelle Risi. Motoja e Ris është “Stabilitet të Qëndrueshëm”*



Thaçi, Ministrit të Mbrojtjes të Kosovës dhe Shefit të Mbrojtjes së Italisë. Gjatë fjalimit, Gjeneralmajor D’Addario theksoi: “Si organizatë ushtarake, ne kemi vazhduar që të sigurojmë se KFOR-i njihet si një Forcë e besueshme, e paanshme dhe e aftë të kontribuoi në mundësinë e hapësirës politike për zgjidhje të qëndrueshme”. Nga ana tjetër, Admirali Foggo vlerësoi gjeneralin D’Addario: “Ka udhëhequr shkëlqyeshëm më shumë se 3.500

trupa që përfaqësojnë 28 kombe, duke ndërthurur aftësi taktike dhe qasje të mprehtë diplomatike”. Kurse në deklaratën e tij të parë, Gjeneralmajori Risi prezantoi moton e tij “Stabilitet te Qëndrueshëm” dhe angazhimin për të mbështetur dialogun dhe bashkëpunimin: “Për të kontribuar në përparimin dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, një rajon me strategji të qëndrueshme, të rëndësishme për tërë regjionin e euroatlantikut”.



STAFI

**DED KOLA**  
Shef i Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

**Gazetarë:**  
Mimoza **GOLIKJA**

**Gazetarë:**  
Saimir **ALIJA**

**Graphic Designer:**  
Afërdita **HYSAJ**

**ADRESA:**  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni “Skënderbej”

# Akademia e Forcave të Armatosura

## Xhaçka: Fillon raundi i dytë i aplikimeve, zgjidhje e sigurtë punësimi

*Raundi i dytë i aplikimeve nis nga data 19 deri më 21 shtator për të gjithë ata që do të jenë brezi i së ardhmes në Forcat e Armatosura*

**A**kademia e Forcave të Armatosura është në pritje të aplikimeve të maturantëve për raundin e dytë. Të gjithë të rinjtë që nuk patën mundësi të aplikojnë për të studiuar në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA) mund ta bëjnë këtë në fazën e dytë. Raundi i dytë i aplikimeve nis nga data 19 deri më 21 shtator për të gjithë ata që do të jenë brezi i së ardhmes në Forcat e Armatosura. Më 21 shtator përfundon afati edhe për këtë kategori aplikantësh, të cilët duhet të plotësojnë formularin pranë gjimnazit ku janë diplomuar, duke zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura si një ndër preferencat e tyre.

Aktualisht po punohet për finalizimin e detyrave kryesore për aplikimin, testimin dhe regjistrimin e kandidatëve për studime në programin "Bachelor" në fushën e shkencës ushtarake.

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka bën me dije se nëse një i ri është në dilemë për të zgjedhur studimet dhe punësimin, është pikërisht kjo akademi që u jep zgjidhje. "Dilemat më të mëdha të të rinjve sot janë studimet dhe punësimi. Zgjidhni Akademinë e Forcave të Armatosura dhe i keni zgjidhur të dyja. Nëse nuk e shfrytëzuar në fazën e parë, keni



mundësi ta bëni tani. Akademia e Forcave të Armatosura ofron ndihmë të jashtëzakonshme gjatë studimeve dhe

karrierë të sigurt pas përfundimit të tyre", -shprehet përmes një statusi në facebook, ministrja e Mbrojtjes Olta

Xhaçka, më 3 shtator 2020.

Me qëllim vijimin e mëtejshëm të procedurave për rekrutimin e kandi-

datëve për oficerë, Akademia e Forcave të Armatosura vë në dispozicion edhe njëherë për të gjithë maturantët, dokumentacinin e nevojshëm që nevojitet mbi kriteret dhe procedurat për rekrutim; formularin e të dhënave personale të aplikantit; formularin e vetëdeklarimit, si dhe të gjendjes shëndetësore të kandidatit për oficer aktiv. AFA ofron një pagesë mujore për çdo student për të gjithë periudhën e studimit si dhe akomodim dhe ushqim falas për tre vitet e studimit. Në fazën e parë aplikuan 675 maturantë për të ndjekur studimet bachelor, nga të cilët u përzgjedhën studentët e parë të shkollës ushtarake. Në përfundim të raundit të tretë pritet të kemi 60 studentët e parë të shkollës sonë ushtarake, shtyllës kryesore të formimit të Forcave të Armatosura.

### AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

## Gati për nisjen e kursit 1-vjeçar për oficer, përfundon testimi fizik

Studimet ushtarake janë një mundësi e mirë edhe për të gjithë të rinjtë që kanë përfunduar studimet bachelor në çfarëdo dege tjetër. Pas përfundimit të aplikimit, të rinjtë që shprehën dëshirën për të studiuar pranë Akademisë së Forcave të Armatosura kanë kryer edhe testin fizik, për të nisur tashmë kursin 1-vjeçar të oficerit.

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, teksa u bën thirrje të rinjve të ndjekin këto studime shprehet më 7 shtator

2020: "Forcat e Armatosura ofrojnë mundësi për karrierë për çdo të ri që dëshiron të shërbejë në uniformë. Krahas mundësive për maturantët që duan të ndjekin studimet në Shkencën Ushtarake dhe atyre që duan të shërbejnë si ushtarë, një mundësi e jashtëzakonshme u ofrohet edhe atyre që i kanë përfunduar tashmë studimet bachelor në çfarëdo degë. Këta të fundit u testuan fizikisht përpara se të nisnin Kursin 1-vjeçar të Oficerit dhe të bëhen pjesë e FA". Këtë

vit u ofruan 60 të drejta studimi për Oficer të ri, për të gjithë ata studentë që kanë përfunduar një fakultet tjetër.

Studimet në këtë kurs do të jenë sipas specialiteteve në FA, ku arsimiti universitar ju përafrohet, si: personeli, logjistikë, xhenjo, forca detare, sinoptika, këmbësoria, etj. Kandidatët e kursit një vjeçar të përgatitjes së oficerit të ri, ju nënshtuan testimit të gjuhës së huaj, fizik, intelektual dhe atij psikologjik.

### Marrëveshja Kosovë-Serbi



## Xhaçka: Të shumtë ishin ata që nuk e besonin të mundur!

**P**aqja dhe bashkëjetesa janë e vetmja e ardhme që meritojnë qytetarët në Ballkan. Kështu ka deklaruar përmes një statusi në rrjetin social facebook, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila ka përshëndetur arritjen e marrëveshjes mes Kosovës e Serbisë në Shtëpinë e Bardhë, në prani edhe të presidentit të SHBA Donald Trump.

"Të shumtë ishin ata që nuk e besonin të mundur! Të shumtë ishin dhe ata që marrëveshjen nuk e donin e bënë gjithçka për ta bërë të pamundur! Por ja që kjo ditë erdhi! Erdhi jo si një mrekulli, por si rezultat i vizionit, besimit dhe guximit të atyre që kuptojnë, se paqja e bashkëjetesa janë e vetmja e ardhme që meritojnë qytetarët e mbarë Ballkanit!

Faleminderit miqve tanë amerikanë! Përgëzime kryeministrit Hoti e urime gjithë shqiptarëve të Kosovës! " - shkruan ministrja Xhaçka. Ajo shton se "Sot u hodh një hap i madh dhe sot të gjithë duhet të bashkohemi për ta çuar punën e nisur deri në fund!"



**N**ë tetor 2020 hapet programi bachelor në Akademinë e FA. Ky është edhe momenti kur akademia do të rifitojë me të drejta të plota rolin e saj si një nga shtyllat e ringritjes dhe modernizimit të FA, duke shërbyer në këtë mënyrë si një institucion i mirëfilltë publik i arsimit të lartë!

Akreditimi i Akademisë së FA si një institucion i arsimit të lartë, nuk është thjesht një mundësi për të përgatitur kuadro më të mirë për nevojat e mbrojtjes e sigurisë. Kjo është edhe një mundësi e jashtëzakonshme për të thithur talente të reja në familjen tonë, djem e vajza që do të shohin tek FA mundësinë reale për të ndërnuar një karrierë, si profesionistë të arsimuar. Një karrierë që më të aftët e të talentuarit prej tyre mund t'i çojë shumë larg e shumë lart, përtej radhëve të FA sonë, e deri në zyrat e Aleancës ku ne bëjmë pjesë.

Maturantë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm këtë vit, kanë zgjedhur shkencat ushtarake pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, si një prej degëve ku duan të studiojnë. Pak ditë pas përfundimit të aplikimeve, grupi i parë i të rinjve, nisi konkurimin me kontrollin mjekësor dhe testimin fizik përmes ekipit profesionist të mjekëve dhe pedagogëve e specialistëve të edukimit fizik në AFA. Në përfundim të konkurimit do zgjidhen 60 studentët e parë të AFA, që do të nisin vitin akademik në muajin tetor.

Më 28 gusht 2020 ka përfunduar Raundi i parë i aplikimit dhe regjistrimit pranë Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) në programin e studimeve në fushën e Shkencës Ushtarake. Raundi i dytë i aplikimeve nis nga data 19 deri më 21 shtator për të gjithë ata që do të jenë brezi i së ardhmes në Forcat e Armatosura.

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ka bërë me dije përmes një postimi në rrjetet sociale se, në këtë periudhë, të gjithë maturantët që kanë mbaruar këtë vit arsimin e mesëm mund të aplikojnë në portalin ualbania.al.

Gjithashtu aplikimi vijon të jetë i hapur edhe për maturantët e viteve të shkuara. Më 21 shtator përfundon afati edhe për këtë kategori aplikantësh, të cilët duhet të plotësojnë formularin pranë gjimnazit ku janë diplomuar, duke zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura si një ndër preferencat e tyre.

AFA ofron një pagesë mujore për çdo student për të gjithë periudhën e studimit si dhe akomodim dhe ushqim falas për tre vitet e studimit. Çfarë është më e rëndësishmja, studentët nuk paguajnë asnjë tarifë për studimet dhe në përfundim të tyre punësohen përmes mundësive që japin FA. Në përfundim të Raundit të tretë pritet të kemi 60 studentët e parë të shkollës sonë ushtarake, shtyllës kryesore të formimit të Forcave të Armatosura.



AKREDITIMI I AKADEMISË SË FA SI NJË INSTITUCION I ARSIMIT TË LARTË

# Në tetor 2020 hapet programi bachelor në Akademinë e FA

*Ky është momenti kur akademia do të rifitojë me të drejta të plota rolin e saj si një nga shtyllat e ringritjes dhe modernizimit të FA*



BATALIONI I FORCAVE SPECIALE DHE BATALIONI I MBËSHTETJES ME LUFTIM

## Drejtuesit e rinj: Nënkolonel Ajet Jata dhe kolonel Petrit Dajlani

**D**itën e martë, më 8 shtator 2020, në mjediset e Batalionit të Forcave Speciale (bFS) dhe Batalionit të Mbështetjes me Luftim (bML) u zhvillua ceremonia e prezantimit të komandantëve të batalioneve. Në këtë ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, shefi i Shtabit të FT kolonel Ilirjan Dauti dhe shefat e degëve. Gjeneral brigade Mullai gjatë prezantimit të komandantit të Batalionit të Forcave Speciale nënkolonel Ajet Jata dhe komandantit të Batalionit të Mbështetjes me Luftim kolonel Petrit Dajlani, vlerësoi punën dhe arritjet e shënuara nga këto dy reparte shumë të rëndësishme të Forcës Tokësore. Ai i uroi suksese për detyrën komandantëve të rinj si dhe u kërkoi që aftësitë dhe përvojën e tyre t'a shpalosin më së miri në drejtimin dhe komandimin e reparteve që ata do të drejtojnë.



## FORCA TOKËSORE

# Pas stërvitjes 12 javore, përfundon Kursi XVI "Komando"

*Trupat Komando kanë një histori të gjatë operationale si brenda dhe jashtë vendit, ku për më shumë se 25 vjet kanë dëshmuar histori sukcesi*

**D**itën e hënë më 7 shtator 2020, në mjediset e batalionit Komando, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit XVI "Komando". Në këtë ceremoni morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel David Rroku, komandanti i batalionit Komando nënkolonel Edmond Doda, komandantë të reparteve të Forcës Tokësore si dhe familjarë të kursantëve.

Ky aktivitet, ndryshe nga herët e tjera, nisi me demonstrime stërvitore, ku të ftuarit në këtë ceremoni patën rastin të shihnin nga afër veprimet e trupave "Komando" në disa stacione si: kalimi i brezit të kalitjes, mbijetesë, përgatitje fizike me elementët e rinj sipas modelit amerikan, hyrje në godinë, çlirim pengjesh dhe qitje në nivel skuadre.

Më pas, fjalën e rastit në këtë ceremoninë e mori komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, i cili iu shprehu kursantëve urimet më të mira: "...Sot tha ai, është dita që ju kurorëzoni përpjekjet tuaja 12 javore duke u stërvitur në kushte ekstreme moti dhe terreni, ditën dhe natën duke shpalosur karakterin dhe shpirtin luftarak e të pamposhtur ndaj çdo situatë



në të cilën jeni përballur.

Trupat Komando kanë një histori të gjatë operationale si brenda dhe jashtë vendit, ku për më shumë se 25 vjet kanë dëshmuar histori sukcesi. Ata kanë kontribuar jo vetëm në luftën kundër

terrorizmit, por edhe në shërbim të paqes dhe sigurisë, krah për krah me Aleancën në Irak dhe Afganistan" - tha ndër të tjera gjeneral Mullai.

Komandanti i Forcës Tokësore, falënderoi për punën e shkëlqyer dre-



jtuesit e kursit kapiten Skrapalliu dhe kapiten Feti të cilët nën lidhshpirtin e tyre dhe me punën e palodhur të instruktorëve realizuan me sukses Kursin XVI "Komando".

Më pas, Zall-Herri gjëmoi

sërish nga betimi i trupave "Komando", një betim i cili bën krenar jo vetëm këto trupa, por të gjithë Forcën Tokësore. Ceremonia u mbyll me vendosjen e beretave dhe ndarjen e certifikatave.

## VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DATË 27 GUSHT 2020

# Ministria e Mbrojtjes: Sipërfaqja 2.488m<sup>2</sup> në Brar i kalon Ministrisë së Kulturës

**M**e propozimin të Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave më datë 27 gusht 2020 ka miratuar vendimin për "Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, të një sipërfaqeje truadhi funksional dhe të disa objekteve, brenda teritorit të pronës Nr.98, me emërtim "Grup depo (ish reparti ushtarak Nr.5001)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin Nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, të ndryshuar".

Vendimi i mësipërm është marrë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar.

Këshilli i Ministrave më datë 27 gusht 2020 ka miratuar ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, të një sipërfaqeje truadhi funksional dhe të disa objekteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2 488 (dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) m<sup>2</sup>, nga truadhi funksional i pronës nr.98, me emërtim "Grup Depo (Ish-Reparti Ushtarak nr.5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planrilevimit që



i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për magazinimin e dekoreve dhe skenografisë së institucionit në varësi të saj, për Teatrin e Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor.

Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqen truadhi funksional dhe objektet, sipas planrilevimit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2 488 (dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) m<sup>2</sup>, nga truadhi funksional i pronës nr.98, me emërtim "Grup Depo (Ish-Reparti Ushtarak nr.5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi, ose në përdorim Ministrisë së Kulturës.

Ministrisë së Kulturës i ndalohej të ndryshojë destinacionin e përdorimit të objekteve dhe sipërfaqes së pronës nr.98, të përcaktuar në pikën 1, të

këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë atë në përdorim të tretëve.

Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, para fillimit të punimeve, Ministria e Kulturës të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës dhe çdo element që lidhet me rrethimin, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prekin gjurma e sipërfaqes së pronës e cila i kalon në përgjegjësi administrimi, sipas parametrave dhe kushteve teknike dhe për këtë të hartohet aktmarrëveshje ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Komanda Mbështetëse.

Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e pronës nr.98, me emërtim "Grup Depo (Ish-Reparti Ushtarak nr.5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin standard të inventarizimit dhe në planrilevimin që i bashkëlidhet këtij vendimi. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Kulturës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare"



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Debat për zbarkimin e trupave italiane në Vlorë

Kanë kaluar plot 100 vjet nga Lufta e Vlorës e vitit 1920. Lufta pati rëndësi të veçantë për ruajtjen e pavarësisë të Atdheut dhe ecurinë e mëtejshme të tij.

Shqipëria e vendosur në pozicionin kyç e shtrirë në brigjet lindore të Adriatikut, e ndodhur afër Italisë, e në kryqëzimin e rrugëve midis lindjes dhe perëndimit, lejonte të ndërmerreshin operacione ushtarake në të dy krahët. Këto vlera strategjike që parqiste Shqipëria përbënin faktorët themelorë të vëmendjes e të synimeve të udhëheqjes politiko-ushtarake të Italisë ndaj Shqipërisë.

Interesat e shtetit italian për Shqipërinë e sidomos për Vlorën ishin të hershme, qysh 3-4 dekadat e fundit të shek. XIX. Ato u shfaqën më qartë në fillim të shek. XX, kur po dukej çarja e Perandorisë Osmane dhe u thelluan me fillimet e Luftës së Parë Botërore, kur dukej se po krijoheshin mundësi praktike për arritjen e këtyre objektivave.

Sipas trajtesës që parashtrohet në librin e Zyrës së Historisë të Shtabit Madhor të ushtrisë italiane, rezultojnë se zbarkimi i trupave italiane në Vlorë në fillimet e Luftës së Parë Botërore ka shkaktuar debate ndërmjet ushtarakëve dhe personeliteteve të Ministrisë së Jashtme, nisur nga vlerësime të ndryshme strategjike. Gjenerali Kodovra, Shef i Shtabit Madhor mbështetur kryesisht në vlerësimet strategjike, dërgimin e trupave e quante një ndërmarrje të rrezikshme e me pasoja shkatërrimtare. Kjo për arsye të terrenit të vështirë dhe të përvojës e mjeshtrisë të shqiptarëve në luftën guerile. Populli shqiptar, theksonte Kodovra, është luftëtar dhe mjeshër në luftën guerile. Vlorë ishte patjetër në vëmendjen e të dy palëve, por për gjeneralin Kodovra mjaftonte të mbahej gjiri i Vlorës, detyrë kjo që mund të kryhej me anën e flotës e të aviacionit dhe të lehtësohej edhe nga zotërimi i ishullit të Sazanit. Përkundrazi në qëndrimin e ministrit të Jashtëm Sonino, mbizotëronin kryesisht vlerësimet politike.

Zotërimi i Vlorës dhe i krahinës së saj, veçse si një bazë e rëndësishme strategjike, sipas ministrit të Jashtëm, krijonin terrenin e përshtatshëm për arritjen e protektoriatit të Shqipërisë si një objekt i rëndësishëm i politikës italiane.

#### Aventura shqiptare

Ndërkaq gjeneral Kodovra këmbëngul në bindjen e tij se ekspedita e Shqipërisë përbënte një difekt të qartë në konceptin e drejtimit ushtarak, si dhe fillimin e aventurës shqiptare. Qëllimi politik shpjegon gjenerali, që të vihet në jetë është i varur nga

## 1920-2020: 100 vjetori i Luftës së Vlorës

# Debat në strukturat italiane për Luftën e Vlorës të vitit 1920



mundësitë ushtarake. Direktivat politike duhet të jenë të tilla që të mund të zbatohen ushtarakisht, ato duhet të jenë në përpjestim të drejtë me mjetet. Rrjedha e ngjarjeve dhe disfatat e italianëve në Vlorë ishin një provë e pikëpamjeve të Kodovës.

Sigurisht gjatë Luftës së Parë Botërore dhe me mbarimin e saj, shteti italian bëri përpjekje të shumta në rrugën diplomatike, duke përdorur forma nga më të ndryshmet për të arritur objektivat e tij. Situata e favorshme dukej se po krijoheshin me miratimin më 9 dhjetor 1919 nga përfaqësuesit e Anglisë, Francës dhe të SHBA të një memorandum, sipas të cilit i njiheshin qeverisë italiane sovraniteti i plotë mbi Vlorën dhe krahinat e saj, si dhe mandati mbi shtetin shqiptar të cunuar.

Por entuziazmi për këtë fitore nuk zgjati shumë. Dy muaj më vonë, presidenti Uillson i nervozuar nga ky amendament, i dërgoi një notë Londrës dhe isiston në të cilën, protestonte ndaj këtij copëtimi të ri të Shqipërisë që bëhej pa dijeninë dhe miratimin e qeverisë amerikane dhe në kundërshtim me protestat energjike të popullit shqiptar. Kjo ndërhyrje e vendosur e presidentit Uillson, ndikoi pozitivisht në zgjidhjen e problemit të kufijve të shtetit shqiptar.

#### Luftë të armatosur, pavarësisht vështirësive

Me dështimin e rrugëve diplomatike, Ministria e Jashtme italiane, duke u mbështetur në vlerat dhe dobinë e Vlorës, mbajti një qëndrim qartësisht të vendosur për pushtimin e saj nëpërmjet luftës së armatosur, pavarësisht nga vështirësitë. Ndërkohë, fillimi i luftës e vuri shtetin italian përballë situatash të paparashikuara. Plani i kryengritjes për fazën e parë të luftës u hartua nga komisioni ushtarak, organ pranë Komitetit të "Mbrotjejs Kombëtare" i përbërë kryesisht nga oficerë shqiptarë

që kishin mbaruar Akademitë Ushtarake. Në hartimin e planit, komisioni ushtarak mbante paarsysh se lufta do të zhvillohej nga një ushtri kryengritëse e organizuar me shpejtësi, e armatosur keq, por me moral të lartë dhe e vendosur ta çonte deri në fund misionin e saj, lufta zhvillohej kundër një armiku të fuqishëm, të organizuar e të përgatitur ushtarakisht, të armatosur me tekniken luftarake më moderne të kohës. Komisioni ushtarak mbante paarsysh gjithashtu se gjendja morale e ushtrisë italiane ishte e dobët, e se do të luftonte në një vend të huaj, në një territor të ashpër malor e pjesërisht kodrinor. Mbrojtja e armikut, edhe pse ishte e fortifikuar, ajo mbështetej në garnizone që lejonte boshllëqe e ndërhapësira të theksuara midis tyre.

Duke vlerësuar drejt tërësitë e këtyre kushteve, në themel të Luftës së Vlorës ishte lufta e shpejtë, sulmuese, që do të zhvillohej brenda një kohe të shkurtër e me karakter vendimtar. Efektshmëria e këtij plani u vlerësua gjerësisht, madje edhe nga autorë të huaja, studiuesit italian Beneditto Caganilia, në vlerësimin e tij për planin shkruan "...ky plan revolucionar (kryengritës) në pamjen e tij paraqet kriterin më të mirë taktik të momentit".

Natën e 5 qershorit forcat kryengritëse kaluan në sulm të menjëhershëm e të befasishëm kundër garnizoneve italiane të shpërndara në trekëndëshin Llogora-Drashovicë-Tepelenë. Luftimet kundër garnizoneve të armikut u zhvilluan me një teknikë tepër primitive. Forcat kryengritëse shfrytëzuan me mjeshtri terrenin dhe sulmuan natë, pozicionet e nisjes u zgjedhën në lartësi dominuese, sulmi natën ndikoi në rritjen e befasisë së goditjes edhe në kushte kur forcat italiane ishin vënë në gatishmëri luftarake.

Ndryshe nga dinamizmi dhe shpirti i lartë sulmues që karakterizonte veprimet luftarake të forcave kryengritëse, taktika mbrojtëse e italianëve u karak-

terizua nga pasiviteti i theksuar. Garnizonet italiane që ndodheshin jashtë Vlorës, nuk bënë asnjë përpjekje për të vendosur bashkëveprimin midis tyre. Po kështu, komanda e trupave italiane në Vlorë, u paraluzua nga forca goditëse e trupave kryengritëse.

Sulmi i menjëhershëm dhe i befasishëm i forcave kryengritëse ishte një sukses i vërtetë. Në mëngjezin e 7 qershorit ishin shkatërruar të gjitha garnizonet italiane jashtë Vlorës, me përjashtim të garnizonit të Tepelenës. Pas humbjeve të shumta që pësuan forcat italiane u mbyllën në Vlorë. Humbjet arrinin deri mbi 200 të vrarë, rreth 1.500 robër, si dhe u zunë sasi të mëdha materilali luftarake. Këto suksese e detyruan opinionin botëror ta shikoj me respekt luftën e popullit shqiptar. Nga forcat kryengritëse pati vetëm 20 të vrarë dhe mbi 30 të plagosur.

#### Mbajtja me çdo kusht e Vlorës

Mbështetur në rezultatet e arritura, forcat kryengritëse mbyllën perimetrin e rrethimit për qark Vlorës dhe përgatiteshin për të kaluar më 11 qershor në mësymje të përgjithshme. Ndërkohë qeveria italiane, duke e vlerësua Vlorën, si një objekt me rëndësi të madhe strategjike, insistoi për mbajtjen me çdo kusht të saj, qoftë edhe vetëm të qytetit me bazën e saj detare, Pashalimanin. Në telegramin që ministri i Jashtëm i Italisë i dërgoi më 12 qershor komisionit të lartë italian në Shqipëri E. Kustoldit thuhet "ju e dini mirë pikëpamjen e qeverisë (Italiane) rreth Vlorës, kjo bazë detare përbën interesin tonë themelor në Adriatik, prandaj kësaj duhet t'i nënshtrohet politika shqiptare jona dhe jo anasjelltas". Mbajtja e Vlorës i jepte mundësi shtetit italian ta përdorte "si një mbështetje ku të ngrinte njerën nga kulmet e portës së Otrantos dhe në të ardhmen të vazhdonte përpjekjet për të arritur protektoriatin e vendit. Pra çlirimi i Vlorës si qëllimi final i kryengritjes

së armatosur ishte kusht i domosdoshëm për të siguruar pavarësinë e vendit.

Kujdes të veçantë i kushtoi komanda italiane fuqizimit të mëtejshëm të mbrojtjes së Vlorës. U intensifikuan punimet mbrojtëse rreth qytetit. Po mbylleshin të gjitha drejtimet me pengesa prej telash me gjëmba e mina, ndërtoheshin fortifikata të reja për vendosjen e artilerisë dhe të mitralozave. Në ullishtet e Vlorës u vendosën autoblanda në prita të maskuara. Po kështu, më 11 qershor zbarkuan me shpejtësi nga Italia reparte arditësh, përforcime me municione, armatime, autoblanda etj.

Plani i mësymjes së përgjithshme të datës 11 qershor parashikonte zhvillimin e saj në mënyrë koncentrike nga tre drejtime me qëllim që të shpërthehej mbrojtja e fortifikuar e armikut, të copëtoheshin forcat e tij, të kapej vargu i kodrave që sundonte Vlorë dhe veriu, lindja e juglindja dhe nga pozita dominuese të vijehej mësymja e vrullshme në drejtim të qytetit. Datë e 11 qershorit forcat kryengritëse kaluan në mësymje të menjëhershme gjatë gjithë perimetrit të rrethimit. Duke patur nismën taktike në duart e tyre e nëpërmjet manovrimesh, përparonin vazhdimisht. Gjatë dy ditë luftimesh të ashpra, të gjitha grupimet mundën të zënë pozicione të përshtatshme, ndërsa një grup luftëtarësh të kryesura nga Selam Musai mbritën rreth 100 m afër shtëpive të para të qytetit. Ndërkohë fillon nga veprimet luftarake edhe qytetarë të Vlorës, të cilët me goditje pas shpine shkaktuan çrregullime e panik në forcat italiane. Sulmi i përgjithshëm i 11 qershorit, megjithëse nuk çoi në çlirimin e Vlorës, përbën në tërësi një fitore të rëndësishme për forcat kryengritëse. Sulmi tregoi se edhe në kushtet e një lufte frontale, forcat kryengritëse i kishin të gjitha mundësitë të shpërthenin mbrojtjen e fortifikuar të armikut. Arritja e objektivit kryesor strategjik u pengua vetëm nga epërsia e theksuar e armikut në forca e sidomos në teknikë luftarake.

## “Dhuro Gjak-Shpëto Jetë”

# Forcat e Armatosura i bashkohen nismës së dhurimit të gjakut

*Iniciativa “Dhuro Gjak-Shpëto Jetë”, bëri bashkë personelin civil dhe ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm, Forcës Tokësore, Komandës Mbështetëse, Arkivit të FA, Institutit të Gjeografisë Ushtarake dhe strukturave të tjera të FA*

Nën kujdesin Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Bajram Begaj, efektive të Forcave të Armatosura më datë 4 shtator 2020, kanë dhuruar vullnetarisht gjak në ambientet e Garnizonit “Skendërbej”, duke iu përgjigjur pozitivisht iniciativës “Dhuro Gjak-Shpëto Jetë”, për të kontribuar në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe njerëzve në nevojë. Iniciativa “Dhuro Gjak-Shpëto Jetë”, bëri bashkë personelin civil dhe ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm, Forcës Tokësore, Komandës Mbështetëse, Arkivit të FA, Institutit të Gjeografisë Ushtarake dhe strukturave të tjera të FA.

Personeli civil i FA dhe djemtë e vajzat në uniformë të batalionit të Këmbësorisë Shkodër, Berat, b2k dhe atij Komando dhuruan gjak në praninë dhe kujdesin e personelit shëndetësor të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, si dhe asistimin e personelit shëndetësor të Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm duke respektuar rregullat e distancimit dhe në përputhje me udhëzimet e dhëna për situatën e krijuar nga COVID-19.

Fillimi i fushatës për dhurimin e gjakut është përshëndetur edhe nga Ministrija e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila tekta poston fotot e ushtarakeve, shkruan më 4 shtator 2020 se: “Kur bëhet fjalë për të shpëtuar jetë, Forcat e Armatosura janë të parët. Qendra e Transfuzionit nis fushatën për dhurimin e gjakut dhe

Forcat e Armatosura janë të parët që i përgjigjen apelit. Efektivë dhe civilë nga të gjitha forcat treguan sërish humanizmin e tyre për bashkatdhetarët tanë më në nevojë!” Gjatë ditës së premte, më 4 shtator 2020, numri i dhuruesve ishte relativisht i lartë, proces i cili po vijon në ditët në vazhdim edhe në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura.

Dhurimi vullnetar i gjakut, tashmë është vlerë e shtuar e vajzave dhe djemve në uniformë dhe personelit civil duke e rritur kështu gamën e kontributeve të FA jo vetëm në misionet paqeruajtëse, luftarake, emergjenca të ndryshme në mbështetje të popullsisë civile siç ishin së fundmi tërmetet dhe pandemia por edhe në iniciativat e dhurimit të gjakut për të pasur gjak të mjaftueshëm e të sigurtë për të gjithë njerëzit në nevojë dhe kryesisht për fëmijët talasemikë.



## Gjashtë armët amerikane që kanë qenë “ferri” për armiqtë e saj



**M-2 “Ma Deuce”**

Mund të duket e çuditshme të klasifikoni një mitraloz tetëdhjetë vjeç si një nga armët më të mira të ushtrisë. Por fakti që M-2 “Ma Deuce” ende po shpërthen pas gati një shekulli dhe luftërave të panumërta është dëshmi për faktin se është një armë e jashtëzakonshme. Dhe kur flasim për armë të fuqishme, ushtria e SHBA-së sigurisht mund të konsiderohet si një lider. Disa mund të jenë shumë të shtrenjta, disa shumë komplekse dhe të tjerat mund të dëshirohen nga politikanët dhe kontraktorët e mbrojtjes, por jo nga trupat armike në fushëbetje.



**AH-64 Apache:**

Është ironike kur mendon se arma më e mirë e forcës tokësore kryesore të Amerikës është një fluturake. Por duke pasur parasysh

konfliktet, ushtria amerikane kohët e fundit ka luftuar dhe ka të ngjarë të luftojë – dhe fuqia e ajrit është faktori më vendimtar. Pajisur me një top prej 30 milimetrash, raketa Hellfire dhe sensorë të sofistikuar, Apache kombinon shpejtësinë, fuqinë e zjarrit dhe një gamë që lejon ushtrinë të godasë armiqtë shumë përpara se të vijnë brenda distancave të qitjes së trupave tokësore të ushtrisë. Kjo fluturake është po aq e dobishme për të gjuajtur kryengritësit, ose duke zbrëthyer kolonat e blinduara të armikut. Apache ka luftuar mirë në konflikte nga “Desert Storm” deri në luftën e tanishme afgane. Një helikopter sulmi nuk është dhe nuk do të jetë kurrë, një zëvendësues i këmbësorisë në tokë. Por trupat tokësore do të vlerësojnë mbështetjen që një helikopter sulmi mund të sigurojë.



**M-1 Abrams:**

Nëse M-1 Abrams është tanku më i mirë në botë, ndoshta edhe nuk mund të thuhet. Por është pa dyshim ndër më të mirët në botë. Me peshë në 60 tonë, M-1A2 ka një top 120 milimetër, ai shkatërroi forcat e blinduara të bëra sovjetike të Irakut në 1991, dhe ka të ngjarë të bënte të njëjtën gjë me tankun e përparuar të Kinës, Type 99. Dhe sipas të dhënave, shumë pak Abrams janë shkatërruar në luftime.

**M-109A6 Paladin:**

Paladin është versioni i fundit i armës vetëlëvizëse M-109 të nderuar. Ajo mund të qëllojë me një predhë 155 milimetra deri në 20 milje duke përdorur predha të ndihmuara nga raketa.



**Raketa Anti-Tank TOW:**

Ndonëse jo pjesa më e fortë, nuk mund të thuhet se ushtria e SHBA-së është më keq, në lojën e raketave anti-tank. Raketa antitank-TOW është ende duke qëndruar e fortë pas gati dyzet e pesë viteve të shërbimit, shkruan nationalinterest. Ajo ka shkatërruar tanke-kryesisht ruse-në Vietnam, luftërat arabo-izraelite, në luftën Iran-Irak dhe tani në Siri. Dhe TOW 2B më i ri vjen në disa versione.

**Armë mitraloz M-2:**

Mund të duket e çuditshme të klasifikosh një mitraloz tetëdhjetë vjeç si një nga armët më të mira të Ushtrisë. Por fakti që M-2 “Ma Deuce” ende po shpërthen pas gati një shekulli dhe luftërave të panumërta është dëshmi për faktin se është një armë e jashtëzakonshme. Zhvilluar kur Franklin Roosevelt sapo ishte bërë president dhe Hitleri sapo po merrte pushtetin në Gjermani, M-2 ka parë shërbimin në të gjithë botën si një mitraloz anti-aeroplan, anti-automjet dhe anti-personel. Dhe një version i azhurnuar së fundmi është ai i M2A1, me shumë avancime.



SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S JENS STOLTENBERG

# Aleanca mbetet vigjilente -mbrojtëse për çdo agresion

*Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s flet me ministrat e Jashtëm të Estonisë, Letonisë, Lituanisë dhe Polonisë*

**S**ekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg zhvilloi biseda telefonike të ndara, me ministrin e Jashtëm Urmas Reinsalu të Estonisë të martën (8 shtator 2020) dhe me ministrat e Jashtëm Edgars Rinkēvičs të Letonisë, Linas Linkevičius të Lituanisë, si dhe Zbigniew Rau të Polonisë, të hënën. Diskutimet përfshinin një varg çështjesh, përfshirë krizën e vazhdueshme në Bjellorusi, përgatitjet për miniseriialin e ardhshëm të NATO-s dhe konsultat e vazhdueshme mbi procesin e reflektimit të NATO-s 2030.

Pilotët luftarakë bullgarë dhe grekë operuan nga aeroportet e tyre bazë në operacionet ndërkuftare për të kontrolluar sigurinë e aviacionit dhe hapësirës ajrore për të arritur një koordinim dhe ndërveprim më të mirë. Një tjetër qëllim i rëndësishëm i trajnimit të përbashkët ishte



rritja e përgatitjes së ekuipazheve për ekzekutimin e saktë të kohës së koordinuar dhe vendosjes së detyrave të fluturimit në hapësirën ajrore të Republikës së Bullgarisë dhe Republikës Greke.

Ushtrimi i parë i përbashkët

i fluturimit me Forcën Ajrore Greke për të kryer një mision për të mbrojtur hapësirën ajrore të dy vendeve në sistemin e mbrojtjes ajrore dhe raketave të NATO-s u zhvillua në 2013 me emrin “DACT - 2013”.

## Ushtarakët ndihmojnë në shuarjen e zjarrit në Stara Zagora

Ushtarët nga Poligoni Qendror i Testimit Teknik të Artilerisë ndihmojnë në shuarjen e një zjarri në rajonin e Stara Zagora. Ushtarakët nga Poligoni Qendror i Testimit Teknik të Artilerisë (CATIP) morën pjesë në kontrollimin dhe shuarjen e një zjarri që shpërtheu në tokën e fshatit Ostra Mogila, komuna Stara Zagora. 20 ushtarakë operuan në terren me dy kamionë zjarrfikës dhe aparate zjarrfikëse. Gjatë natës, njerëzit dhe pajisjet vazhduan aktivitetet e tyre për të kontrolluar

zjarrin së bashku me zjarrfikësit, dhe vazhduan aktivitetin e zjarrfikjes. Ushtarakët ishin nën udhëheqjen e kolonel Evgeniy Dinev-kreu i CATIP. Kurse ushtarët nga Brigada e 61-të e Mekanizuar ne

Struma u angazhuan ne shuarjen e zjarrit mbi Karlovo. Njëzet ushtarakë nga Batalioni i 3-të i Mekanizuar i Brigadës së 61-të të Mekanizuar arriten te eliminojnë pasojat e zjarrit në zonën “Trekëndëshi” mbi ujëvarën “Suchurum” në qytetin e Karlovos. Ushtarakët vepruan nën komandën e Majorit Lachezar Rusekov-Zëvendës Komandant i Batalionit të Tretë të Mekanizuar.



**F**ormacione ushtarake përfaqësues nga Forcat Tokësore, Forcat Ajrore dhe Flota Detare, Komanda e Përbashkët e Operacioneve Speciale dhe Garda Kombëtare morën pjesë më 6 shtator 2020, në festimet kushtuar 135 vjetorit të Bashkimit të Principatës së Bullgarisë me Rumelinë Lindore, në të gjithë vendin. Ushtarakët nga Brigada e 2-të e Mekanizuar dhe Formacioni Ushtarak 24 620-Svoboda nga Forcat Tokësore morën pjesë me demonstrime në Sheshin “Saedinie” para bashkisë në qytetin e Chirpan dhe ushtarakët vendosën kurora dhe lule para Monumentit të Bashkimit në Kopshtin e Qytetit.

Në Ditën e Bashkimit të Bullgarisë, u zhvilluan demonstrime në qytetin e Plovdivit nga përfaqësues të Forcave Tokësore, Forcës Ajrore dhe Komandës së Përbashkët të Operacioneve të Posaçme, si dhe Përfaqësues të Forcave Ajrore ku mori pjesë Presidenti Rumen Radev i cili mbajti edhe fjalim ku tha se “mësimi historik i kësaj ngjarjeje është se ndryshimi drejt më

## Ushtarakët në 135 vjetorin e bashkimit të Bullgarisë



së mirës është i mundshëm kur jemi të bashkuar në mbrojtjen e lirisë, drejtësisë, barazisë para ligjit”. Në festime morën pjesë gjithashtu Kryetarja e Parlamentit Cveta Karajancheva dhe deputetë, kryetari i bashkisë së Plovdivit Zdravko Dimitrov, shefi i mbrojtjes Admirali Emil Eftimov dhe persona të tjerë zyrtarë.

Në vigjilje të përvjetorit të 135-të të Bashkimit të Bullgarisë tek 5 nga hyrjet e qytetit të Plovdivit, si dhe në vende të tjera simbolike valëviteshin 400 flamuj të rinj-200 kombëtare dhe 200 të Plovdivit. Flamujt rinovohen dy herë në vit-në vigjilje të festës kombëtare me 3 mars dhe më 6 shtator-Dita e Bashkimit, e cila është festë e Plovdivit.

Në Sofje, para ndërtesës së Administratës së Presidentit të Republikës së Bullgarisë u zhvillua ndryshimi solemn i rojes së nderit. Ushtarë nga Garda Kombëtare morën pjesë gjithashtu në ceremoninë e vendosjes së kurorave para Mauzoleum-Oshuarisë së Princit Aleksandër I Battenberg.

Më 6 shtator, në qytetin e Stara Zagora, ushtarakët e Brigadës së Dytë të Mekanizuar vendosën kurora dhe lule para Monumentit të Mbrojtësve të Stara Zagora në Parkun e Pestë të Tetorit. Në qytetin Sandanski, ushtarakët nga Komanda e Brigadës marën pjesë në ritualin e vendosjes së kurorave dhe luleve në sheshin qendror. Pjesëtarë përfaqësues të komandës shprehën mirënjohjen e tyre për ata që vdiqën për çlirimin kombëtar dhe bashkimin duke vendosur kurora me lule në sheshin Hristo Botev në Vratsa. Në Burgas qindra qytetarë u përfshinë në “Vallen e Madhe të Burgasit” me perkrahjen muzikore të ansambllit profesional folklorik “Stranxa”.

# Policia, burgjet dhe robërit e Luftës së Vlorës së 1920-ës

NGA ASOC.DR.ZAHO GOLEMI

**Policia dhe burgjet në Luftën e Vlorës – elementë thelbësorë strukturorë të shtetit**

Luftëtarët e '20-ës në Luftën e Vlorës, ishin rraca luftëtare arjane, kasta luftëtare e pamposhtur e Ballkanit, ishin lehtë dhe të tjerë shqiptarë të të gjitha trojeve, atdhetarë që luftuan me shpirt dhe egërsisht kundër pushtimit dhe ushtrisë së një prej superfuqive 40 milionëshe të kohës, Italisë. Luftuan me rrobat e trupit jo me uniforma, me armatim të vjetër dhe me fishekë të paktë, luftuan me shpirtin e zjarrtë për lirinë e kombit. Sikurse shkruante arbëreshi Vinçenco Dorsa, “nuk ka qenie dhe luftëtarë më të zgjuar dhe të egër se shqiptari, sidomos kur mbron trojet e tij, askush si ai”. Shqiptarët para një shekulli në Vlorë i thirri misioni fisnik i shtetit të pavarur, gjaku, dinjiteti dhe krenaria kombëtare. Një prej viganëve të atdhetarisë shqiptare ishte Osmën Haxhiu, Kryetari i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare” dhe udhëheqësit politik të Luftës kombëtare të Vlorës që bashkë me Qazim Kokoshin, Murat Miftarin, Alem Mehmeti, Hamit Selmani, Duro Shaska, Hysni Shehu, Beqir Sulo Agalliu, Myqerem Hamzarai, Qazim Koculi, Sali Bedini, Ali Beqiri, Hazbi Cano, shkruan epopenë e 1920-tës me devizën e njohur: “O Shqipëri, o gur e hi!”. Komandant i Përgjithshëm i Luftës fillimisht u caktua Major Ahmet Lepenica, i cili pas gjashtë ditëve dha dorëheqjen dhe në vend të tij u zgjodh ish-ushtaraku e senatori Qazim Koculi. Komisar i Përgjithshëm i Policisë së Luftës u zgjodh Shero Emini dhe komandant i Burgut të Vajzës Rexhep Sulejmani. Mbi bazën e vendimeve të mençura të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare” u organizua gjykata e luftës me Kryetar Neki Xhenetin, prokuror Rasim Babameto dhe Avdul Kuçi, ndërsa antarë gjyqi Sif Kedhi e Agjah Bej Libohova. Sekretar ishin Meçan Selami nga Kallarati dhe Halim Xhelu nga Tërbaçi. Udhëheqja politike si dhe shtatmadhuria e Luftës përcaktuan rregjimin të rreptë dhe të drejtë për mbajtjen e rendit, qetësisë dhe eliminimin e kriminalitetit përgjatë zhvillimit të veprimeve luftarake, me Komisarin e Policisë së luftës djalin e Ramicës Shero Emini. Ushtria, policia dhe burgjet janë elementë thelbësorë strukturorë të shtetit, prandaj edhe përgjatë Luftës së Vlorës në zbatim të vendimeve të Kongresit të Lushnjës, morën masa për ta bërë shtetin shtet në parametra ligjore e institucionale që gjatë luftës. Fshati Vajzë grumbulloi rreth njëmijëshestatëqind robër ushtarakë italianë, që drejtueshin nga Rexhep Sulejmani (babai i Perlat Rexhepit), bashkë me shumë luftëtarë të tjerë edhe pse nuk kishin shumë dijeni rreth ligjeve ndërkombëtare të luftës, u treguan shumë njerëzorë dhe i respektuan robërit përgjatë gjithë periudhës së luftës. Shqiptarët e njohin fshatin Vajzë si gurgullimë e poezive të poetit të shquar kombëtar Ali Asllani, këshjtjella natyrore e pathyshme, ndërkohë që drejtuesit e Luftës së Vlorës e përzgjodhën si vendi më i përshtatshëm për grumbullimin e robërve përgjatë luftës tre mujore të Vlorës. Vajza është truall me moshën e tokës e shquar në histori në një shpat mali-bedenë e një kalaje natyrore. Burgu i Vajzës nuk ishte “shaka” e një realiteti të hidhur ndërluftues, por një realitet historik.

**Robërit shqiptarë të luftës, fatëkeq të përbuzur e keqtrajtuar nga pushtuesit italianë**

Hulumtimi dokumentar mbi të vërtetat e policisë dhe rolëve të luftës është e mbështetur dokumentarisht. Është fakt se robërit e luftës (të internuarit e të syrgjynosurit) për të arrestuarit nga pala shqiptare ka qenë inicuar fillimisht nga italianët të urdhruar nga Gjenerallejtënant Piacentini që



kërkonte të shuante flakët e urrejtjes që më 16 maj 1920, kur shpalli në mënyrë ultimative gjendjen e jashtëzakonshme duke bërë një varg arrestimesh si Jani Minga, Ali Asllani, Dom Mark Vasa, Hasan Sharra, Muço Sharra, Ali Mihali, Ibrahim Shyti e qindara të tjerë që gjatë gjithë periudhës së luftës arriti në 1460 shqiptarë të arrestuar dhe të dërguar jo në burgjet italiane por në burgun natyror të Grykës së Xhenetit në ishullin e Sazanit. Platforma italiane se nuk ishin robër lufte por “të internuar” ishte një dredhi e pushtuesit. Gryka e Xhenetit në Sazanin shqiptar u shndrua në grykën e ferrit, për gjithë robërit shqiptarë të luftës. Por një pjesë e tyre u mbajt edhe në anijet e luftës të italianëve. Një ndër figurat e ndritura të luftës që bëri të minimizohej rrëmbimi i robërve shqiptarë ishte atdhetari At Shtjefën Gjeçovi që vepronte në qytetin e Vlorës në këtë kohë dhe ishte kthyer në mbrojtës i vendosur i qytetarëve të Vlorës nga rrëmbimet e pushtuesve (më vonë Shtjefën Gjeçovi largohet nga Vlorë dhe shërben famulltar në Pukë, Shkodër e Prizren). Robërit e luftës u kthyen në “mollë shërr”, ndërkohë që shqiptari nuk e ka për zakon të dhunojë më të vegjëlit, të vobektit dhe të mundurit. Është fakt se komandant e të dy kraheve përlloragitan mbi bazën e të dhënave se për çdo ushtar/officer italian të kapur rob ose edhe të ishte vetëdorzuar kishte një shqiptar të rrëmbyer, përfshi dhe civilët e paangazhuar. Kështu në Gjirin e Vlorës, ndodhej edhe flota italiane me anijet “San Mario”, “Bruceti”, “Dulio”, “Alkina”, “Orion”, torpedinierët “Arcione”, vapori “Lloyd Triestino”, ku në disa prej tyre kishte rreth 300 robër të rrëmbyer në qytetin e Vlorës dhe rrethinat e saj. Në një letër që Ministri i Drejtësisë Hoxha Kadria i dërgonte Gjenerallejtënant Settime Piacentini, ishte në unison me letrën të posaçme, që edhe dhe vetë Kryeministri Sulejman Delvina u dërgoi Ministrave të Punëve të Jashtme të Francës, Italisë, Anglisë dhe Amerikës, në të cilat shkruhej: “..Autoritetet italiane duke mos bërë asnjë dallim midis luftëtarëve naciona-

listë dhe qytetarëve pa armë, dmth të banorëve të territorit të pushtuar prej tyre, që kanë qëndruar ndër vatra të tyre e nuk janë përzierë në veprime luftarake, i kanë marrë këta dhe i kanë përqëndruar këta në ishullin e Sazanit, kënd ky i zhveshur nga banesat, drunjët, ujët e pishëm e nga çdo tjetër, për t'i shtrënguar të vdesin, duke i mbajtur si robër lufte, megjithëse ekzistenca dhe liria e qytetarëve të paarmë është një parim i pranuar nga drejta ndërkombëtare... Kanë marrë gjithashtu gratë dhe fëmijët duke i grumbulluar ata në spitalin civil, fare afër zonës së zjarrit, pa marrë në konsideratë as moshën e tyre... të burgosurve nuk u japin veçse një copë bukë të thatë... Dhunimet kalojnë çdo cak hyjnor e njerëzor duke zbrapsur drejt barbarisë. Letra parashikonte mençurisht edhe thyerjet flagrante të “artikullit 38 të Brukselit” (Ins. Amerikan, artikulli 22 dhe 23 i Manualit të Oksfordit; artikulli 49, rregullorja e Hagës, artikulli 46. Letra kishte marrë shkas nga mos respektimi i asnjë konvente ndërkombëtare të deriatëkohshme, dhe mosnjohja e mosrespektimi i rregullave të luftës. Nga ana tjetër kemi dy trajtime të robërve. Shqiptarët që ndoshta pjesa më e madhe nuk i njihje rregullat e luftës dhe të drejtat e robërve sipas konventave ndërkombëtare. Por shqiptarët në lidhje me trajtimin e robërve, kishte forcën e moralit dhe aspektet kanunore të mirëtrajtimin të tyre. Ndërsa pala pushtuese në një farë mënyre u hakmor për humbjet njerëzore e materiale dhe për më tepër humbjen e fuqisë pushtuese. Një ndër faktet më domethënëse është se truri drejtues politik dhe ushtarak i Luftës së Vlorës përveç krijimit të policisë së luftës, krijoi edhe sistemin e burgjeve të luftës me robërit oficerë e ushtarë të ushtrisë pushtuese italiane të kapur gjatë luftimeve ose të dorëzuar. Policia e luftës komandohej nga profesionisti Shero Emini dhe disa ditë pas fillimit të luftës në funksione të policimit të luftës dhe ruajtjes së qetësisë dhe Major A. Lepenica. Ndërsa burgju-kamp natyral i Vajzës komando-

hej nga Rexhep Sulejmani.

**Fshati Vajzë i traditës, mençurisht dhe mirëtrajtimin të të burgosurve italianë më 1920**

Zgjedhja e fshatit Vajzë si “burgju natyror”, për robërit italianë nga Komiteti “Mbrojtja Kombëtare” e Osman Haxhiut, por bashkarisht edhe me Këshillin e Ushtarakëve akademikë ishte një zgjidhje optimale për situatë luftarake. Por përse u zgjodh “Vajza”, për burgun e italianëve? – Gjithë oficerët e ushtarët e zënë robër dërgoheshin në Vajzë sepse këtë kamp e kishin ngritur vetë italianët, ndodhej pranë Kotës, në mes të rrugës Vlorë-Gjirokastrë, ishte në mes të fshatit, kishte klimë të shëndetshme, “..këtu shumë prej italianëve kishin banuar edhe më parë dhe ishin si në shtëpi të tyre pasi i kishin të gjitha komoditetet, me të cilat ushtari italian, si kolonizator i lindur, rrethohet pa vonë kudo që ngulet, qoftë edhe për një kohë të shkurtër” (A.Agaj; Uji, klima, banesat ishin të mira, komandanti i ri i kampit ishte edhe më i mirë e i njohur për sjellje të urta e të buta e plot ndërgjegje. Shqiptarët nuk i shanin, rrinin ose vrisnin, përkundrazi kishin sjellje bujare të pashoqe. Edhe kur ndonjë rob rebelohej, shante ose revoltohej, sjellja shqiptare ishte e duruar. Kurrë në tre muaj lufte ndonjë lab nuk ngriti dorë kundër robërve, as ja ktheu sharjeve. Sipas dëshmisë okulare të kohës, “..në kampin e Vajzës robërit ishin plotësisht të lirë, hynin e dilnin nëpër fshat, përhapeshin nëpër fshatra të tjerë e ktheheshin në darkë në folenë e tyre. Italianët këtë sjellje të shqiptarëve nuk e kuptonin, sepse vetë ishin mësuar të silleshin keq e t'i linin të vdisnin urie robërit e tyre austro-hungarezë. Robërit italianë përdorëshin prej fshatarëve të Vajzës edhe për punë sic ishin korrja e të lashtave në fshatrat përreth Vajzës, pasi të zotët ndodheshin në luftë dhe gjithë bereqeti ishte nëpër ara. Për herë të parë në historinë e luftave në truallin shqiptar kemi një trajtim krejtësisht të civilizuar dhe me tipare të plota

njerëzore. Në ditët e para të fillimit të Luftës së Vlorës dhe pikërisht disa ditë pas fillimit të luftimeve një delegacion i Qeverisë së Tiranës i kryesuar nga Ministri Spiro J. Koleka mbriti në fshatin Vajzë. Ishte data 9 qershor kur KMK-ja kishte bërë ultimatumin e dytë ndaj Gjenerallejtënantit Settime Piacentini, ku i kërkohej që ushtria italiane të hiqte dorë nga lufta dhe sidomos nga masakrimi i banorëve të qytetit të Vlorës dhe fshatrave përreth, por edhe ndaj shqiptarëve të rrëmbyer e të burgosur padrejtësisht. Pra ka qenë data 1 korrik 1920, kur Spiro Koleka, Prefekti i Drashovicës Qazim Kokoshi dhe anëtarët e Komitetit të fshehtë “Mbrojtja Kombëtare” Hazbi Cano e Myqerem Hamzaraj nga Drashovica shkuan në Kotë dhe vizituan të plagosurit e luftës. Këtu ekipi drejtues është prituar nga doktori Shezai Çomo, ku u bisedua për kujdesin për të plagosurit e palës sonë por edhe të palës italiane. Ndërsa të rënë dëshmorë varroseshin “ku i zinte balta” (për t'u grumbulluar pas lufte). Ndërsa të vrarët italianë varroseshin nga vetë robërit italianë sipas udhëzimeve të KMK-së. Pas Kotës përfaqësia e grupit më të lartë drejtues të Luftës kombëtare të Vlorës shkuan bashkarisht në kampin-burg të të burgosurve italianë në rrethinat e fshatit Vajzë. Porosia e qeverisë së Sulejman Delvinës si dhe e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare” e Osman Haxhiut për italianët e kapur ose vetëdorzuar si robër të luftës ishte: trajtimi i tyre me dinjitet, me robërit të kishte sjellje të mirë, të trajtoheshin njerëzisht, dhe sipas praktikave të zakonave shqiptare, duke i trajtuar jo si armiq por “në besë të shqiptarit”. Përfaqësuesit më të lartë u kujdesën tek organet drejtuese dhe ruajtëse të burgut që robërit italianë të kishin njafutëshëm ushqime, ilaçe e veshmbathje. Fillimi i muajit korrik pati zhvillime, të cilat mësoheshin dhe dëgjoheshin me vëmendje të madhe edhe nga robërit e luftës. Kështu Kriministri Italian G. Xholiti, kishte deklaruar në parlament se “hiqte dorë nga mandate mbi Shqipërinë dhe pranonte pavarësinë e plotë të saj”, por nën pretekstin e sigurisë në Adriatik kërkonte të mbante tre pika strategjike Sazanin Karaburunin si dhe Pashalimanin. Për këtë në Shqipëri vjen baron Alioti, i cili takohet me Piacentinin në Vlorë dhe në Durrës mbrin në 3 korrik, dhe më tej vijon diskutimet me qeverinë e Tiranës duke kërkuar marrëveshje por duke mbajtur disa pika strategjike në gjirin e Vlorës. Ndër katër pikat e propozuara në të katër takimet e baronet Alioti në bisedimet e 4 korrikut 1920, me Spiro Koleka, Ahmet Mati dhe Nuri Villa dekonspirohen nga gazeta italiane “Corriere della Serra” të datës 14 korrik 1920. Delbi i marrëveshjes ishte: “Italia të zbrazë Vlorën dhe dorëzojë administratën në duart e Qeverisë së Tiranës; Qeveria të pushojë kryengritjen në Qarkun e Vlorës; Robërit italianë të zënuar prej kryengritësve do të dorëzohen në Komandën e Italisë me nderime ushtërore dhe një komision i përbashkët italo-shqiptar ka për të marrë pjesë në zbrazjen e Vlorës”. KMK-ja e vendosur, por edhe qeveria “S. Delvina” kundërshtoi energjikisht më 5 korrik që italianit të mbante pika strategjike në Vlorë.

Më 10 korrik Baroni Italian sërish në Vlorë, “për t’i blerë mendjen” KMK-së, ku ra në kontakt me udhëheqësit e KMK-së nëpërmjet Ulise Bosio dhe një ushtaraku të marinës luftarake; (shih A. Baldacci, Studi specialit albanesi, vol III, Roma, 1937, f.36). Fakt është se kjo është një periudhë kur robërit e luftës po shtoheshin në të dy kampet dhe përfaqësisht sa ushtarakë italianë kishte robër në Vajzë po kaq kishte robër edhe nga shqiptarët robër dhe të çuar në Grykën e Xhenemit në Sazan. Në këtë periudhë KMK-ja që ishte truri drejtues politik më i lartë i luftës merr vendim dhe ja dërgon me një letër baronet Aliotti, ku në thelb shkruanin se: “... nuk pranojmë që as në siujdhesën e Sazanit të qëndrojmë këmbë ushtari italian”. Acarimi ishte i lartë që ndihej edhe në të dy burgjet e kundërshtarëve. Më 17 korrik 1920 lëshohet urdhëri nga shtabi më 12 gjeneralë i Piaçentinit: “... jemi dhe do të qëndrojmë në Vlorë...”, duke e shoqëruar këtë urdhër me një mësimje të përgjithshme në drejtim të kryengritësve, dhe me forca e mjete të shumta edhe në drejtim të aksit Drashovicë-Kotë-Vajzë, por që në fakt rezultoi një dështim i plotë, sepse shqiptarët të vendosur natën e 23 korrikut dhanë kundërmësimjen më të fuqishme dhe më të papërbalueshme nga italianët duke i detyruar të struken në pikat afër bregdetit të Vlorës në priti të urdhërave “për të mbathur opingat”.

### E vërteta për robërit e burgut të Vajzës dhe sjellja kalorësiake e fisnike e shqiptarëve

Fakt është se historia ndodh vetëm një herë, por shkruhet dhjetra herë. Megjithatë e vërteta është vetëm një, ndërkohë kur këndshikimet janë të shumta. Luftën në Vlorë dhe të vërtetat e saj sado që i “burgoste” një shtet i madh 40 milionësh, shqiptarët kanë një maksimumë proverbiale që i kapërcen shekujt, “nuk mbulohej dielli me shoshë”. Opinioni evropian kërkonte informim dhe një grup gazetarësh italianë, gjermanë, francezë etj., shkuan në frontin e luftimeve në Drashovicë, por edhe u takuan me komandantin e burgut Rexhep Sulejmani si dhe drejtpërdrejtë me robërit italianë në Vajzë. Gazeta “La Tribuna” botoi një intervistë të gazetarit amerikan të famshëm për kohën Hiram K. Moderwell, i cili ishte gazetari i “Daily New” i Çikagos. Gazetari amerikan Moderwell kishte shkuar në Burgun e Vajzës ku ruheshin rreth 1700 oficerë e ushtarë italianë dhe kishte shprehur habi që ishte lejuar pa asnjë pengesë për takim dhe bisedim të lirshëm me robërit e burgosur si dhe mësoi shumë mbi trajtimin e tyre. Edhe pse ata ruheshin në “telat me gjëmba”, që vetë italianët i kishin sjellë në Shqipëri, të burgosurit ndjeheshin të lirë. Gazetari që u pa sy më sy me robërit italianë dhe që bashkëbiseduan shtruar në garnizonin e robërve italianë në Vajzë. Ja çfarë shkruante një shekull më parë gazetari amerikan: “...shqiptarët sillshin kalorësisht me robërit italianë dhe lëndoi shumë ndjenjat kombëtare dhe njësinë e mendimeve që mbretërojnë sot në Shqipëri...” (gazeta “Kuvendi”, Romë 13.7.1920.). Por artikujt e gazetarëve amerikanë dhe evropianë në këtë periudhë ishin të shumtë duke u shndruar syri dhe veshi evropian dhe amerikan për kohën, sikurse intervistat me Ministrin pa protokol të qeverisë “S.Delvina”, që mbronte kauzën e së vërtetës në një kohë të madhe rreziku. Gazetarët euro-amerikanë u detyruan që të përgjeshtronin vetëveten si dhe të pohonin me vërtetësi se çfarë ndodhte me robërit italianë në fshatin Vajzë të Vlorës. Gazetarët patën rast të takonin njerëz të shkolluar, mjaft inteligjentë e drejtues lufte, që ishin në të drejtën e tyre. Ata takuan dhe njohën edhe “shqisën e gjashtë” të komandantëve lebër në luftime, që dinin të gjenin saktësisht orën dhe minutën ekzakte të sulmit, mbrojtjes, dhe rrëmbimit të robërve potencialë. Në shtypin evropian në korrikun e 1920-tës vetëm një muaj pas fillimit të veprimeve luftarake

çlirimtare erdhën artikuj informativë të kronikanëve të luftës që përgjeshtruan kronikat e mëparshme për mjerimin e robërve italianë në Shqipëri. Krijtësisht e kundërta ndodhte me të rrëmbyerit dhe të burgosurit shqiptarë që ishin jo në Itali por në tokë dhe det shqiptar, në burgun natyror të grykës së Xhenemit ku ishin të burgosur (të internuar sipas italianëve) 1460 shqiptarë si dhe rreth 300 të tjerë që ishin në anijet italianë që gjendeshin në ujërat tona territoriale në gjirin e Vlorës (në dokumentet italianë evidentohen 200 robër). Mbi bazën e të dhënave dokumentare të deritanishme as gazetarët italianë nuk kishin mundësi ta preknin ferrin e Grykës së Xhenemit dhe as të shikonin keqtrajtimin e robërve shqiptarë për të cilin kishin ngritur zërin dhjetra herë personalitete shqiptare, por dhe gazetarë shqiptarë brenda e jashtë atdheut. Këtu përfshihen edhe të ngarkuarit nga KMK-ja si Komisioni i jashtëm që punonte për Shqipërinë nga Korfu si Hamza Isai –kryetar, Eshref Dano dhe Naqe Konomi, që ishin të ngarkuar që zhvillimet e Luftës së Vlorës t’ja bënin të ditur diplomacisë evropiane. Kësaj i shërbenin edhe shkrimet në “La patria”, “Epoka”, “Resto del Carlino”, “Petit Marseillai”, “Avanti”, “Kuvendi”, “Popolo d’Italia”, pavarësisht rezervat e redaktimit, si dhe gazetaret “Drita” të Veli Harshovës Gjirokastër, “Kuvendi” “Dielli” të Bostonit etj. Qeveria dhe KMK-ja nëpërmjet Spiro Kolakës si dhe anëtarëve më të lartë të “Komisionit”, hapi dritën jeshile Kryqit të Kuq amerikan që ndihmoi në shuarjen e plagëve të mëdha të luftës jo vetëm në Drashovicë e Kotë por edhe në garnizonin-burg të fshatit Vajzë, ku ishin një masë e konsiderueshme robërisht të vetëdoruar ose të kapur në luftime gjatë Luftës së Vlorës. Fakt është se nga kundërmësimja e përgjithshme e sukseshme shqiptare e 23 korrikut 1920, që vendosi një vijë të re luftimesh duke zbrapsur ushtrinë italianë nga Xhamia e Plumbit në Skelë, duke i vendosur italianët në pozitat luftarake më të keqe të mundshme. Tek robërit e të dy kampeve shikoheshin drita shprese, sepse italianët duke parë gjendjen tragjike dhe në prag katastrofe, qeveria e Xholiotit hodhi poshtë marrëveshjen Titoni-Venizello të 29 korrikut 1919, tërhoqi baron Aliotti nga Tirana dhe dëgoi kontin G. Manzoni për bisedime të reja. Bisedimet për nënshkrimin e kapitullimit Italian dhe nënshkrimin e paqes u bënë mes Ministrin S. Koleka dhe kontin G. Manzoni më 29 korrik 1920, bisedime që zgjatën deri më 2 gusht 1920, ku Kryeministri S. Delvina dhe konti G. Manzoni nënshkruan Protokollin midis dy qeverive të Tiranës dhe të Romës. Me këtë rast në axhendën e aktivitetit bashkëpunues të protokollit u zgjidh edhe çështja e robërve të luftës.

### Policia e Luftës së Vlorës një shekull më parë – profesionale dhe e sukseshme

Policia e Luftës ishte një zgjidhje e mencur i KMK-së. Përgjatë gjithë periudhës së luftës tregoi angazhim serioz dhe profesionalizëm, eliminim të krimeve dhe ruajtjen e qetësisë publike. Edhe gazetarët ndërkombëtarë që erdhën në korrik 1920 njohën dhe panë veprimin energjik dhe profesionalizëm e Policisë së Luftës që komandohej nga Shero Emni, të kudogjendur në ndihmë të fshatarsisë së zonës së luftës, të karvaneve me ushqime, armë e municion që vinin e ktheheshin, të ruajtjes së qetësisë dhe sigurisë ditën e natën, të patrullimit, të komunikimit të vazhdueshëm me KMK-në dhe Shtabin e luftës, të lejimit të takimeve që bënte Ulise Bozio dhe një marinar italian si të dërguarit e Piaçentinit me drejtuesit politikë e luftarakë të luftës, të kapjes dhe çuarjes përpara gjykatës së luftës të tradhëtarëve dhe sabotatorëve të luftës, apo të infiltuarve italoifilë në radhët e luftëtarëve apo që mund të vepronin si “mbështetës” të luftës si dhe dhjetra detyra të tjera. Policia e luftës zgjidhi një sërë detyrash të tjera

si në mbrojtje artilerinë e Luftës, që ishte zënë pushtuesve, mbrojtje municionet, depot, mitralozat, magazinat e ushqimeve, siguroi spitalin e Kotës. Ekspertiza e Policisë së luftës në funksione edhe xhandarmërie e milicie ishte një ndihmesë e drejtpërdrejtë si faktor mbështetës fitoreje.

### Shkëmbimi i robërve, përfundimi i luftimeve si modalitete protokollare të fundluftrave

Edhe pse nga grypa e pushkëve, mitralozave e topave ende vinte era barot ishte pragu i paqes së pritshme. Në tetë pika të protokollit, që të gjitha ishin thelbësore sepse lejonin që Vlorë të bashkohej me “Shqipërinë Londineze”, duke përmbyshur dëshirën e mbarë shqiptarëve. Por protokollit kishte dy pika në interes të robërve të Vajzës dhe ishullit të Sazanit. Pika 6, “Të dyja palët të bëjnë një amnisti” dhe pika 7 “të gjithë shtetasit italianë dhe shqiptarë të arrestuar liroheshin brenda afatit të zbrazjes së Vlorës”, këto dy pika pasoheshin me pikën 8 të protokollit “Ky protokoll do të mbahej i fshehtë”, sepse “dardha e kishte bishtin prapa”, që italianët ta mbanin ishullin deri kuru a rrëmbyen gjermanët në shtator 1943 ndërsa do të ngelej tokë e robëruar deri më 22 tetor 1944, kur partizanët e BrXIIS e rimorën atë përfundimisht në administrimin shqiptar. Gushti i vitit 1920 u shndrua në muaji i paqes së brishtë, por gjithësesi me armët në gatishmëri, sepse mirëbesimi kishte brenda dyshimin mbi pabesinë.



Robërit italianë, që ishin familiarizuar me fshatarët e Vajzës, ishin shndruar si bijtë e tyre, por mendja e zemra e tyre ishte në vendlindje matanë detit. Përfundimi i luftimeve dhe nënshkrimi i protokollit të 2 gushtit 1920 ishte shpresë gëzimi se do të shkonin pranë familjeve të tyre. Disa prej tyre kishin ardhur nga garnizone të ndryshme italiane si “mysafirë” në një “kazermë” shqiptare në Vajzë. Luftëtarët e cetave të Fushëbardhës të Novruz Bello e Zhulati të Mersin Gjoçës, të vëllezërve komandues me një nënë Lufto Kondi dhe Aliko Aliko, por dhe shumë çeta të tjera nga Tepelena, Gjirokastra e gjithë Labëria kishin çuar robërit italianë nga Tepelena në Vajzë. Por këtu ishin edhe robërit nga garnizonet e Matohasanit, Kotës, Drashovicës, Llogorasë, Kaninës, Vajzë, Dukat, Penkovë, etj. Angazhimi i çetave shqiptare edhe në mbarëvajtjen e veprimtarisë për robërit e luftës vinte pas kryerjes me sukses të veprimeve për eliminimin e garnizoneve italiane sipas përcaktimit të shtabeve politike dhe luftarake të KMK-së të Luftës së Vlorës. Angazhimi i mëtejshëm në Vajzë, ku ishte kampi i robërve italianë e më tej në veprime luftarake të drejtpërdrejta i shndruan luftëtarët shqiptarë në fisnikërinë e kohës dhe në aristokratët e luftës, me sjellje njerëzore, si të ishin njohës të legjislacionit ndërkombëtar. Protokollat ndërkombëtarë “mbi robërit e luftës”,

u bënë jo rrallëherë tema e bisedave të djemve të shkolluar shqiptarë brigjeve të fshatit Vajzë, por dhe në frontin e çeliktë të luftës pakompromis të shqiptarëve.

### Zona neutrale tampon, finalizimi i marrëveshjes për robërit dhe burgjet në Vlorë

Nga dokumentat e Luftës së Vlorës në lidhje me robërit e të dy palëve gjejmë dokumente që flasin qartë në lidhje me pikën e parë të “Protokollit”, që, “çështjet e të dyja vendeve do të zgjidheshin nga një komision i përbërë prej italianësh dhe shqiptarësh. Për këtë më 8.8.1920 dhe ditët që pasuan Ministri S. Koleka dhe kolonel Kostoldi u takuan shumë herë në lidhje me zbrazjen e Vlorës dhe sidomos për lirinë e të burgosurve të Vajzës si dhe të burgosurve dhe të internuarve të Grykës së Xhenemit në Sazan dhe të burgosurve shqiptarë që mbaheshin në anijet e luftës italiane në gjirin detar të Vlorës. Në mbrëmjen e 15 gushtit dhe mëngjesin e 16 gushtit 1920, elita politike dhe ushtarake e Luftës së Vlorës respektuan marrëveshjen mbi bazën e Protokollit të nënshkruar në Tiranë. U realizua zbrazja e zonës neutrale nga vija e pozicioneve të zjarrit, ku forcat kryengritëse ishin në pozicione shumë dominuese mbi Vlorë. Tërheqja u krye deri në brigjet lindore të lumit Shushicë, ku përqëndrimet maksimale ishin në Drashovicë. Operacionin mbykqyrës nga pala shqiptare e drejtonte nga Xhandarmëria shqiptare kapiten Ferid Frashëri dhe toger Tosun Selenica,

për dy javë, në ditët në vijim u realizua lirimi i mbi 1700 robërve italianë të luftës duke u përcjellë me dinjitet nga komandanti i kampit Rexhep Sulejmani dhe stafi i tij, Policia e luftës e komisar Shero Emni, përforcime luftëtarësh të cetave, por edhe nga strukturat politike e ushtarake të Luftës së Vlorës. Nga ana tjetër edhe italianët realizuan kthimin e 1460 të burgosurve të burgut të grykës së Xhenemit si dhe rreth 300 të burgosurit që mbaheshin në anijet luftarake italiane. Veprimtaria e ushtarakëve sidomos e xhandarmërisë shqiptare në fazën finale të Luftës Kombëtare të Vlorës, meriton të vlerësohet dhe të nxirren të vërtetat, sepse luftëtarëve, drejtuesve dhe ushtarakëve pjesëmarrës u takon aureola e përjetësisë, sepse Atdhedashuria nuk është profesion por ndjesi kombëtare dhe “...një ish-ushtar i Atdheut është gjithmonë ushtar i Atdheut edhe kur shuhet”. Historiografia është kursyer për të shkruar sa e si duhet për Ahmet Lepenica, Ali Beqir Velça, Avdurraman Çiraku, Kanan Maze të tre të diplomuar në Akademinë Ushtarake në Stamboll, Azis Çami i diplomuar në Akademinë Ushtarake në Torino, Itali, Qazim Koculi i diplomuar në Akademinë Ushtarake në Stamboll, Shero Emni i diplomuar në Akademinë Ushtarake në Vjenë, Austri; sikurse edhe oficerët kapiten Mehmet Fega-Xhelili komandant i çetës së Sevesterit, kapiten Toto Hosi, komandant i çetes së Bolenës; toger Kanan Maze, komandant i çetës së Shkozës; artilieri Ali Beqir Xhuveli; Major Adem Riza Hoxha, komandant nga Kavaja, kapiten Ferit Frashëri komandant i çetës së Korçës

etj., oficerë karriere të shquar në jetën ushtarake, shoqërore e familjare, por mbi të gjitha për shërbime të shquara ndaj kombit shqiptar. Heroizmin dhe trimëritë shqiptare në të gjitha frontet e luftës u shkruan edhe vetë italianët pas luftës, në publikime të ndryshme, përfshi këtu edhe trajtimin e robërve italianë, por këtë realitet historik e zhduku me urdhër Musolinit, pas ardhjes në pushtet, edhe pse miqësia qëndron në zemër të popujve. Sipas Ago Agaj, që i referohej fundgushtit e pragfitores së 3 shtatorit 1920, “pak ditë më parë ishin liruuar dhe të gjithë ushtarakët italianë të zënë rob prej shqiptarëve dhe të syrgjynosurit tanë në Sazan dhe ishin sjellë në shtëpirat e tyre në qytet dhe ushtarakët italianë në skelë për tu imbaruar në anije për t’i çuar në Itali...”, edhe pse pas 19 vjetësh ushtria italianë erdhin sërish më 7.4.1939, për “të marrë hak” për 1920-ën dhe për realizimin e objektivave gjeostrategjike dhe gjeopolitike në Ballkan.

(Me rastin e 100 vjetorit të Luftës së Vlorës, në përkujtim të 3460 robërve shqiptarë dhe italianë të të dy kampeve ndërluftuese, që ishin izoluar përkatësisht 1700 oficerë e ushtarë italianë në Vajzë të Vlorës dhe 1460 shqiptarë të izoluar në Grykën e Xhenemit në Sazan ndërsa 300 robër në anijet luftarake italiane).



## “DHURO GJAK-SHPËTO JETË”

# Forcat e Armatosura dhurojnë gjak në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe njerëzve në nevojë

Veç misioneve paqeruajtëse brenda e jashtë vendit, Forcat e Armatosura rreshtohen të parët për të shpëtuar jetë, për të kontribuar në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe njerëzve në nevojë. Djemtë e vajzat e FA i janë bashkuar nismës “Dhuro Gjak-Shpëto Jetë” duke treguar humanizmin e tyre me bashkatdhetarët në nevojë. Teksa poston fotot e ushtarakëve, Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka shkruan më 4 shtator 2020: “Kur bëhet fjalë për të shpëtuar jetë, Forcat e Armatosura janë të parët. Qendra e Transfuzionit nis fushatën për dhurimin e gjakut dhe Forcat e Armatosura janë të parët që i përgjigjen apelit. Efektivë dhe civilë nga të gjitha forcat treguan sërish humanizmin e tyre për bashkatdhetarët tanë më në nevojë!”

